PJESA JURIDIKE NGA PROVIMI SHTETËROR
PËR DOKTORËT E STOMATOLOGJISË
PYETJE
BAZA E PYETJEVE

LIGJI PER SIGURIM SHËNDETËSOR

1. Sigurimi shëndetësor në Republiken e Maqedonisë Veriore është:

a) solidar dhe i barabartë
b) i detyrueshëm dhe vullnetar
c) jo obligativ dhe vullnetar
d) liberal dhe i lirë

2. Bazuar në sigurimin e detyrueshëm shëndetësor të të siguruarit, të drejta për mbrojtje shëndetësor që bien në barrë te Fondit kanë edhe anëtarët e familjes:

a) vëllezërit dhe motrat e personit të siguruar

b) prindërit e personit të siguruar

c) bashkëshorti/tja dhe fëmijët e lindur brenda ose jashtë martese, thjeshtërit, fëmijë të adoptuar dhe fëmijët e marrë në përkujdesje

d) farefisi në vijë të drejtë deri ne brezin e dytë

3. Për dërgim të personit të siguruar për trajtim mjekësor jashtë vendit vendos:

a) specialist në degën përkatëse

b) komisioni i veçantë në Fondin për Sigurim Shëndetësor

c) klinika univerzitare nga dega përkatëse/e veprimtarise perkatese

d) mjeku amë i personit të siguruar

4. Kush është i autorizuar të përcaktojë shumën e pjesëmarrjes me fonde personale për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore dhe barërave (bashkë-pagesa ose participimin) si dhe lirimin nga participimi:

a) drejtori i institucionit shëndetësor në të cilin kryhet shërbimi
b) Ministri i Shëndetësisë
c) Fondi për Sigurim Shëndetësor
d) mjeku që ka kryer shërbimin

5. Personat e siguruar të drejtat e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, brenda vëllimit të të drejtave të përcaktuara me ligj, i relaizojnë në bazë të:

a) të dhënave elektronike në bazën e të dhënave të Fondit të Sigurimit Shëndetësor se është paguar kontributi për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor

b) vërtetimit nga punëdhënësi për kontribut të paguar për sigurimin e detyrueshëm shëndetësor

c) vërtetimit te punësimit nga Agjencia e Punësimit

d) çertifikatës nga libri amë i të lindurve

6. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor në Republikën e Maqedonisë Veriore zbatohet nga:

a) Qeveria

b) Fondi për Sigurim Shëndetësor

c) Ministria e Shëndetësisë

d) Kuvendi

7. **Në shërbimet themelore shëndetësore të personave që kanë sigurimin e detyrueshëm shëndetësor përfshihen gjithashtu edhe:**

a) pajisjet dentare sipas indikacioneve të përcaktuara nga akt i përgjithshëm i Fondit të Sigurimit Shëndetësor
b) të gjitha pajisjet dentare
c) pajisjet dentare sipas indikacioneve të përcaktuara nga një akt i institucionit në të cilin janë përpunuar
d) pajisjet dentare sipas indikacioneve të përcaktuara nga mjeku

8. Në sigurimin e detyrueshëm shëndetësor nuk janë të përfshiera shërbimet shëndetësore të kryera në institucionet shëndetësore që janë jashtë rrjetit të institucioneve shëndetësore, përfshirë edhe :
a) të gjitha mjetet dentare

b) mjetet dentare që nuk janë të mbuluara nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor ose janë përpunuar nga materiale të standardit të larte në pjesën e diferencës midis çmimit referues të përcaktuar nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor dhe çmimit të blerjes

c) vetëm mjetet dentare të përcaktuara nga institucioni ku janë përpunuar me material të standardit të lartë

d) mjetet dentare të përcaktuara nga mjeku sipas një vlerësimi të pavarur profesional

9. Në mbrojtjen primare shëndetësore stomatologjike, shërbimet shëndetësore të personave të siguruar ofrohen nga:

a) doktor i stomatologjisë - Specialist në Stomatologjinë Pediatrike dhe Parandaluese

b) të gjithë specialistët e lëmisë së stomatologjisë

c) doktori i zgjedhur – doktor I stomatologjisë nga mbrojtja primare shëndetësore stomatologjike

d) doktor i stomatologjisë - Specialist i Ortodoncisë dhe Doktor i Stomatologjisë - Specialist i Kirurgjisë Orale

10. Mjeku/doktori i zgjedhur është i detyruar ti ofrojë personit të siguruar shërbime shëndetësore nga mbrojtja primare shëndetësore stomatologjike dhe të përcjell shëndetin e tij, si dhe në rast të mungesës së tij ose pengesës së përkohshme për punë, pacientëve të tij:

a) nuk është i detyruar t'u sigurojë atyre një zëvendësim

b) është i detyruar t'u sigurojë atyre një zëvendësim me një mjek përkatës nga mbrojtja primare shëndetësore stomatologjike

c) është i detyruar t'u sigurojë atyre një zëvendësim me ndonjë mjek nga lëmia e stomatologjisë brenda rrjetit të institucioneve shëndetësore

d) mund të sigurojë zëvendësimin nga vlerësimi i nevojave shëndetësore të pacientit

LIGJI PËR MBROJTJE SHËNDETËSORE

11. Nocioni i mbrojtjes shëndetësore është përkufizuar në:

a) Ligjin për Sigurimin Pensional dhe Invalidor
b) Ligjin për Mbrojtjen e Popullatës nga Sëmundjet Infektive
c) Ligjin për Mbrojtjen Shëndetësore
d) Ligjin për Sigurim Shëndetësor

12. Veprimtaria shëndetësore është një veprimtari me:

a) interes personal

b) interes të etnive dhe grupeve të caktuara

c) interes publik

d) interes të përbashkët

13. Doktorët e mjekësisë, doktorët e stomatologjisë dhe farmacistët e diplomuar mund të kryejnë shërbime shëndetësore në mënyrë të pavarur:

a) pasi të kenë kaluar provimin profesional dhe duke marrë një licencë pune

b) pas përfundimit të punës provuese, dhënien e provimit profesional dhe marrjen e licencës së punës

c) duke përfunduar punën provuese dhe duke kaluar provimin profesional

d) pas përfundimit të punës provuese dhe marrjes së licencës së punës

14. Mbikëqyrjen inspektuese mbi ligjshmërinë e punës së organizatave shëndetësore dhe mbi punën profesionale të punonjësve shëndetësorë si dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë, e kryen:

a) Qeveria
b) Oda Mjekësore, Oda Stomatologjike dhe Oda Farmaceutike
c) Ministria e Shëndetësisë
d) Fondi i Sigurimit Shëndetësor

15. Periudha e punës provuese për doktorët e stomatologjisë të cilët kanë përfunduar studime gjashtëvjeçare zgjat:

a) 6 muaj
b) 10 muaj
c) 12 muaj
d) 18 muaj

16. Doktorët e stomatologjisë mund të specializohen nëse:

a) kanë përfunduar punën provuese dhe kanë kaluar provimin profesional
b) kanë përfunduar punën provuese, kanë dhënë provimin profesional dhe posedojnë licencë pune
c) kanë përfunduar punën provuese dhe posedojnë licencë pune
d) kanë dhënë provimin profesional dhe posedojnë licencë pune

17. Punonjësi shëndetësor është:

a) doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjisë dhe faramcist i diplomuar si dhe personat me arsim të mesëm, shkollë të lartë ose arsim i lartë profesional të kryer në fushën e mjekësisë, stomatologjisë dhe farmacisë
b) vetëm doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjisë dhe farmacist i diplomuar
c) doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjisë dhe persona me arsim të mesëm, të lartë ose të lartë profesional të kryer në fushën e mjekësisë dhe stomatologjisë
d) persona me arsim të mesëm, të lartë ose të lartë profesional të përfunduar në fushën e mjekësisë, stomatologjisë dhe farmacisë

18. Lëshimi, përtëritja (rinovimi), vazhdimi dhe revokimi i licencës për punë të punonjësve shëndetësorë me arsim të lartë (doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjisë dhe farmacist i diplomuar) bëhet nga: 0.5 p.

a) Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit Shëndetësor
b) shoqatat profesionale nga fusha përkatëse
c) Oda Mjekësore, Oda Stomatologjike dhe Oda Farmaceutike
d) klinikat universitare nga fusha përkatëse

19. Veprimtaria shëndetësore kryhet:

a) vetëm në rrjetin e institucioneve shëndetësore
b) në rrjetin e institucioneve shëndetësore dhe jashtë rrjetit të institucioneve shëndetësore
c) vetëm jashtë rrjetit të institucioneve shëndetësore
d) nuk ka ndarje të veprimtarisë në rrjet dhe jashtë rrjetit të institucioneve shëndetësore

20. Veprimtaria shëndetësore në rrjetin e institucioneve shëndetësore kryhet:

a) vetëm nga institucionet publike shëndetësore
b) institucionet shëndetësore publike dhe private që kryejnë veprimtari në bazë të licencës
c) vetëm institucionet shëndetësor private që kryejnë veprimtari në bazë të licencës
d) institucionet shëndetësore publike, institucionet shëndetësore private që veprojnë në bazë të licencës dhe shoqëritë tregtare për nevojat e punonjësve të tyre

21. Rrjeti i institucioneve shëndetësore paraqet:

a) përcaktimin e numrit të nevojshëm të institucioneve shëndetësore dhe llojet e veprimtarisë shëndetësore, përkatësisht specialitetet që ofrohen në zona të caktuara gjeografike sipas vendbanimit të shfrytëzuesve të mbrojtjes shëndetësore, të cilat duhet të sigurohen në përputhje me nevojat e mbrojtjes shëndetësore të popullsisë në territorin e Republikës së Maqedonisë Veriore

b) përcaktimin e një numri arbitrar të institucioneve shëndetësore dhe llojet e veprimtarisë shëndetësore, përkatësisht specialitetetet që ofrohen në zona të caktuara gjeografike pavarësisht vendbanimit të shfrytëzuesve të mbrojtjes shëndetësore dhe pavarësisht nga nevojat e mbrojtjes shëndetësore të popullsisë në territorin e Republikës së Maqedonisë Veriore

c) përcaktimin e një numri të caktuar të institucioneve shëndetësore dhe llojet e veprimtarisë shëndetësore, përkatësisht specialitetet që ofrohen në zona të caktuara gjeografike sipas vendbanimit të shfrytëzuesve të mbrojtjes shëndetësore, i cili jo domosdoshmërisht duhet të sigurohet në përputhje me nevojat e mbrojtjes shëndetësore të popullsisë në territorin e Republikës së Maqedonisë Veriore

d) përcaktimin e institucioneve shëndetësore dhe llojet e veprimtarisë shëndetësore, përkatësisht specialitetet që ofrohen në zona të caktuara gjeografike sipas kërkesave të institucioneve që duan të kryejnë veprimtari në rrjet dhe të cilat duhet të sigurohen në përputhje me kërkesat dhe vlerësimet e punëtorëve shëndetësorë në territorin e Republikës së Maqedonisë Veriore

22. Niveli i veprimtarisë shëndetësore është organizimi i veprimtarisë shëndetësore, në varësi të detyrave dhe kompleksitetit të tij, ndahet në:

a) parandalim, trajtim, kujdes dhe rehabilitim
b) masat për parandalimin, masat për zbulimin e hershëm dhe masat për çrrënjosjen e sëmundjeve, lëndimeve dhe çrregullimeve shëndetësore
c) nivelin primar, sekondar dhe terciar të mbrojtjes shëndetësore
d) nivelin individual të mbrojtjes, nivelin e mbrojtes grupore dhe nivelin e mbrojtjes shoqërore

23. Ndihma emergjente stomatologjike përfshin:

a) trajtimin akut të rasteve dentare në ndërrimin e tretë, si dhe gjatë festave, ditëve jopune dhe fundjavave
b) trajtimin e rregullt të rasteve dentare në të gjitha ndërrimet, si dhe gjatë festave, ditëve jopune dhe fundjavave
c) trajtimin e rregullt të rasteve dentare vetëm në ndërrimin e tretë, dhe trajtimin akut gjatë festave, ditëve jopune dhe fundjavave
d) trajtimin akut të rasteve dentare vetëm në ndërrimin e tretë, ndërsa trajtimin e rregullt gjatë pushimeve, ditëve jopune dhe fundjavave

24. Veprimtaria stomatologjike si pjesë e veprimtarisë shëndetësore përfshin:

a) kujdes dhe rehabilitim
b) veprimtarinë parandaluese, kuruese dhe protetike
c) masat për parandalimin, zbulimin e hershëm dhe çrrënjosjen e sëmundjeve
d) parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin

25. Institucionet shëndetësore që kryejnë veprimtari stomatologjike në nivelin primar janë:

a) ordinancat, poliklinikat, laboratorët dentarë dhe shtëpitë e shëndetit
b) ordinancat, poliklinikat, laboratorët dentarë, shtëpitë e shëndetit dhe qendrat klinike universitare në përputhje me natyrën e veprimtarisë dhe me qëllim të zbatimit të veprimtarisë arsimore dhe veprimatarisë kërkimore-shkencore
c) spitale të përgjithshme, të specializuara dhe klinike
d) institutet dhe klinikat universitare

26. Mjek i zgjedhur në fushën e stomatologjisë është:

a) doktor i stomatologjisë nga mbrojtja primare shëndetësore stomatologjike
b) doktor i stomatologjisë - Specialist në Protetikën Dentare
c) doktor i stomatologjisë - Specialist i Ortodoncisë
d) doktor i stomatologjisë - Specialist në Stomatologjinë Pediatrike dhe Parandaluese

27. Ordinancat ne nivelin primar të fushës së stomatologjisë ushtrojne veprimtari shëndetësore nëse i kanë të plotsuara kushtet për:

a) protetikë stomatologjike
b) stomatologji të përgjithshme
c) ortodonci
d) kirurgji orale

28. Shtëpia e shëndetit kryen veprimtari stomatologjike në fushën e:

a) ndihmës emergjente stomatologjike dhe mbrojtjes stomatologjike për të gjithë pacientët
b) ndihmës emergjente stomatologjike dhe mbrojtjes stomatologjike të fëmijëve deri në moshën 14 vjeç
c) ndihmës emergjente stomatologjike dhe mbrojtjes stomatologjike për pacientët mbi 60 vjeç
d) veprimtarisë parandaluese, kuruese dhe protetike për të gjithë pacientët

29. Spitali ditor është një mënyrë e trajtimit të pacientit, sipas së cilës për shërbimet shëndetësore për diagnostikim, terapi, kujdes dhe rehabilitim që kryhen në nivelin sekondar:

a) nuk kërkohet qëndrim në spital më shumë se 8 orë në ditë
b) kërkohet një qëndrim në spital pa kufizim në kohëzgjatjen e trajtimit
c) kërkohet një qëndrim në spital prej 8 deri në 24 orë
d) nuk kërkohet fare qëndrim në spital

30. Licenca e punës është një dokument publik që:

a) dëshmon llojin dhe nivelin e arsimimit të punonjësit shëndetësor
b) dëshmon aftësinë profesionale të punonjësit shëndetësor për kryerjen e shërbimeve shëndetësore
c) nuk dëshmon aftësinë profesionale të punonjësit shëndetësor dhe nuk ka ndonjë rëndësi për të drejtën e kryerjes së shërbimeve shëndetësore
d) dëshmon nivelin, llojin dhe shkallën e arsimit të punonjësit shëndetësor dhe nivelin e aftësisë profesionale

31. Bartës të veprimtarisë shëndetësore janë:

a) doktorë të mjekësisë, doktorë të stomatologjisë dhe farmacistë të diplomuar me provim profesional të kaluar, të cilët nuk kanë nevojë të kenë licencë pune
b) punonjës shëndetësorë me arsim të mesëm në fushën e mjekësisë, stomatologjisë dhe farmacisë me licencë pune përkatëse
c) bashkëpunëtorët shëndetësorë të të gjitha profileve
d) doktorë të mjekësisë, doktorë të stomatologjisë dhe farmacistë të diplomuar me licencë pune përkatëse

32. Udhëzimi profesional është:

a) një grup përfundimesh të zhvilluara në mënyrë sistematike për suksesin dhe efikasitetin e mënyrave dhe procedurave të trajtimit të një gjendje të caktuar shëndetësore, të cilat bazohen në vlerësimin e dëshmive për mënyrat më të përshtatshme të trajtimit shëndetësor të pacientëve (mjekësi e bazuar në prova/dëshmi)

b) shqyrtim i pikëpamjeve për suksesin dhe rekomandimet për efikasitetin e mënyrave dhe procedurave të trajtimit të një gjendje të caktuar shëndetësore, të cilat bazohen në shkëmbimin e përvojave të punonjësve shëndetësorë

c) analizë e konkluzioneve/përfundimeve për suksesin dhe efikasitetin e mënyrave dhe procedurave për trajtimin e një gjendje të caktuar shëndetësore, të cilat bazohen në njohuritë e punonjësve shëndetësorë që e kanë arritur me punën e tyre të përditshme

d) mendim i konsoliduar i mjekëve për suksesin dhe rekomandimet e tyre për efikasitetin e mënyrave dhe procedurave për trajtimin e një gjendje të caktuar shëndetësore, të cilat bazohen në mendime, përvoja dhe njohuri praktike

33. Licenca e punës lëshohet:

a) për periudhë pesë vjeçare

b) për periudhë tre vjeçare

c) për periudhë shtatë vjeçare

d) për gjithë jetën

34. Doktor i mjekësisë, doktor i stomatologjisë dhe farmacist i diplomuar mund të marrë një licencë pune nëse:

a) ka përfunduar arsimin perkatës në fushën e mjekësisë, stomatologjisë, gjegjësisht farmacisë, ka kryer punën provuese dhe ka dhënë provimin profesional

b) ka përfunduar arsimin e duhur në fushën e mjekësisë, stomatologjisë, gjegjësisht farmacisë dhe ka kryer punën provuese

c) ka përfunduar arsimin e duhur në fushën e mjekësisë, stomatologjisë, gjegjësisht farmacisë dhe ka kryer provimin profesional

d) ka kryer punën provuese në mjekësi, stomatologji, gjegjësisht farmaci dhe ka kryer provimin profesional

35. Licenca për punë e një doktori të stomatologjisë mund të rinovohet (përtëritet) nëse në periudhën e vlefshmërisë së licencës, me zhvillim të vazhdueshëm profesional duke ndjekur risitë në stomatologji dhe duke përmirësuar njohuritë e tij, ai ka fituar një numër të duhur pikësh dhe:

a) për tërë periudhën e vlefshmërisë së licencës së punës ka punuar në veprimtarinë për të cilën ka licencë pune

b) të paktën 60% të kohës së vlefshmërisë së licencës së punës ka punuar në veprimtarinë për të cilin ka licencë pune ose në mbrojtje shëndetësore stomatologjike

c) të paktën 20% të kohës së vlefshmërisë së licencës së punës ka punuar në veprimtarinë për të cilën ka licencë pune dhe kohën tjetër të punës në mbrojtje shëndetësore stomatologjike

d) të paktën 80% të kohës së vlefshmërisë së licencës së punës ka punuar në mbrojtje shëndetësore stomatologjike

36. Një doktor i stomatologjisë ose një specialist në fushën e stomatologjisë i cili nuk plotëson kushtet ligjore për rinovimin (përtëritjen) e licencës së punës mund t'i vazhdohet licenca e punës përkohësisht, për gjashtë muajt e ardhshëm dhe më pas të rifitojë licencën e punës, me kusht që:

a) në këtë periudhë prej gjashtë muajsh të ketë përfunduar me sukses trajnimin shtesë dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale në përputhje me programin për trajnim shtesë dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale të miratuar nga Oda Stomatologjike

b) pas skadimit të kësaj periudhe prej gjashtë muajsh të ketë përfunduar me sukses trajnimin shtesë dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale në përputhje me programin për trajnim shtesë dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale e miratuar nga Oda Stomatologjike

c) në këtë periudhë prej gjashtë muajsh të ketë përfunduar me sukses trajnimin shtesë dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale në një institucion shëndetësor të zgjedhur nga vetë doktori

d) pas skadimit të kësaj periudhe prej gjashtë muajsh të kërkoj ri-lëshimin e licencës për punë, pavarësisht detyrimit për trajnimin shtesë dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale në përputhje me programin për trajnim shtesë dhe vlerësimin e njohurive dhe aftësive profesionale e miratuar nga Oda Stomatologjike

37. Një nga kushtet për rivokimin e përkohshëm të licencës për punë të doktorit të stomatologjise ose specialistit në fushën e stomatologjisë, gjë qe mund të kryhet për një periudhë maksimale prej shtatë vjetësh, është:

a) nëse doktori nuk e rinovon licencën për punë brenda afateve të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje Shëndetësore

b) nëse doktori nuk fillon punë në institucionin në të cilin ai ka kryer punën provuese

c) nëse doktori e vazhdon licencën për punë brenda afateve të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje Shëndetësore

d) nëse doktori nuk themelon një institucion shëndetësor privat në përputhje me licencën e punës

38. Revokimi i përhershëm i licencës së punës bëhet nëse:

a) me akt të Odës Stomatologjike doktori përjashtohet nga anëtarësia në Odë

b) me vendim të drejtorit të institucionit shëndetësor ku është i punësuar, vërtetohet se doktori ka bërë një lëshim ose gabim profesional në punën e tij me cka ka shkaktuar dëmtim të përhershëm të shëndetit ose vdekjen e pacientit

c) me vendim gjyqësor të formës së prerë vërtetohet se doktori nuk ka bërë një lëshim ose gabim profesional në punën e tij me cka nuk ka shkaktuar dëmtim të përhershëm të shëndetit ose vdekjen e pacientit

d) me një vendim gjyqësor të formës së prerë vërtetohet se doktori ka bërë një lëshim ose gabim profesional në punën e tij me cka ka shkaktuar dëmtim të përhershëm të shëndetit ose vdekjen e pacientit

39. Kundër vendimit për revokim të përkohshëm dhe të përhershëm të licencës së punës, doktori:

a) nuk ka të drejtë ankese

b) ka të drejtë të ankohet në Shoqatën Stomatologjike të Maqedonisë

c) ka të drejtë ankese tek Ministri i Shëndetësisë

d) ka të drejtë ankese në institucionin shëndetësor në të cilin ka qenë i punësuar para marrjes së vendimit

40. Specializimet dhe sub-specializimet në fushën e stomatologjisë zbatohen në:

a) institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet shëndetësore të akredituara nga Ministri i Shëndetësisë me orar të plotë

b) institucionet shëndetësore në të cilat specijalizanti ka qenë i punësuar, pa marrë parasysh akreditimin nga Ministri i Shëndetësisë

c) institucionet shëndetësore të akredituara nga Ministri i Shëndetësisë, pa ndjekur pjesën e programit dhe planit në institucionet e arsimit të lartë

d) institucionet e arsimit të lartë, pa ndjekur pjesën e programit dhe planit në institucionet shëndetësore të akredituar nga Ministri i Shëndetësisë.

41. Statutin e Odës e sjell:

a) Kuvendi i Odës

b) Ministri i Shëndetësisë

c) Kryetari i Komisionit për Çështje Profesionale Stomatologjike

d) Kryetari i Bordit Drejtues të Odës

42. Organi më i lartë i Odës është:

a) Kuvendi i Odës

b) Kryetari i Komisionit për Çështje Ekonomike

c) Kryetari i Odës

d) Kryetari i Komisionit për Çështje Profesionale

43. Mbikëqyrja profesionale e punës së punëtorëve shëndetësor kryhet nga Odat, në bazë të një plani vjetor për mbikëqyrje profesionale mbi punën e institucioneve shëndetësore dhe punëtorëve shëndetësor, i cili miratohet nga:

a) Ministri i Shëndetësisë

b) Bordi Mbikëqyrës

c) Kryetari i Odës

d) Fondi i Sigurimit Shëndetësor

44. Mbikëqyrja inspektuese mbi ligjshmërinë e punës së Odave në kryerjen e autorizimit publik bëhet nga:

a) Ministria e Shëndetësisë dhe Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor

b) Fondi i Sigurimit Shëndetësor

c) Bordi Drejtues

d) Kryetari i Odës

LIGJI PËR EVIDENCA NË SFERËN E SHËNDETËSISË

45. Institucionet shëndetësore, dokumentacionin mjekësor themelor në lidhje me trajtimin stomatologjik e mbajnë sepse:

a) janë të detyruar t'a evidentojnë vetëm me kërkesë të pacientit

b) janë të detyruar të mbajne evidencë

c) nuk janë të detyruar të mbajne evidencë

d) janë të detyruar të mbajne evidencë sipas vlerësimit të vetë mjekut

46. Punonjësi shëndetësor, gjatë kryerjes së ekzaminimeve shëndetësore, përkatësisht shërbimeve që ka kryer, në dokumentacionin mjekësor themelor është i detyruar:

a) të shënoj komentet e veta, pavarësisht nga gjetjet dhe rezultatet e ekzaminimit

b) të bëjë vlerësimin nëse duhet të shënoj gjetjet dhe rezultatet e ekzaminimit, gjegjësisht shërbimet e kryera

c) të shënoj gjetjen dhe rezultatet e ekzaminimit, gjegjësisht shërbimet që ka kryer

d) të kërkojë pëlqim nga secili pacient individual për të shënuar gjetjen dhe rezultatet e ekzaminimit, gjegjësisht shërbimet që ka kryer

47. Punonjësi shëndetësor është i detyruar të konfirmojë gjetjen dhe rezultatet e ekzaminimit, përkatësisht shërbimet e tjera që i ka ofruar, si dhe të konfirmojë të gjitha të dhënat që i ka shënuar në evidencat individuale ose evidencat përmbledhëse:

a) me nënshkrimin dhe vulën e tij ose me nënshkrimin e tij elektronik

b) me një deklaratë në fund të secilës evidencë

c) nuk është i detyruar t'i konfirmojë ato me ndonjë akt ose veprim

d) me një koment të dhënë pacientit gojarisht pas evidentimit të të dhënave

48. Për tërësinë dhe saktësinë e të dhënave të shënuara në evidencat që i referohen gjetjes dhe rezultateve të ekzaminimit, përgjegjës është:

a) drejtori i institucionit në të cilin është bërë konstatimi dhe është kryer ekzaminimi

b) punonjësi shëndetësor i cili regjistron të dhënat në mjetet për evidencë, ndërsa për saktësinë e të dhënave të dhëna me deklaratë është përgjegjës vetë personi që ka dhënë deklaratën

c) pacienti për të cilin janë evidentuar gjetjet dhe rezultatet e ekzaminimit

d) nuk është përgjegjës as punonjësi shëndetësor që i shënon të dhënat, as personi që jep të dhënat me deklaratë

49. Në institucionet shëndetësore dokumentacioni themelor mjekësor ruhet për 15 vjet nga evidentimi i fundit i të dhënave, karta shëndetësore dhe historia e sëmundjes mbahen për 15 vjet pas vdekjes së pacientit, ndërsa karta stomatologjike:

a) ruhet përgjithmonë

b) ruhet për 15 vjet pas vdekjes së pacientit

c) nuk ruhet fare

d) ruhet për një vit

50. Lidhur me të dhënat shëndetësore dhe personale që institucionet shëndetësore mbajnë, ata:

a) nuk janë të detyruar t'i përgjigjen kërkesës së individit për një kopje të të dhënave të tij shëndetësore dhe personale

b) janë të detyruar me kërkesë të individit dhe mbulim te shpenzimit nga ana tij, të japin një kopje të të dhënave shëndetesore dhe personale por vetëm nëse ka kërkesë për një gjë te tillë dhe paraprakisht ju është dhënë edhe deklaratë për arsyetim të kërkesës

c) janë të detyruar me kërkesë të individit dhe mbulim te shpenzimit nga ana tij, të japin një kopje të të dhënave shëndetesore dhe personale

d) janë të detyruar të informojnë bartësin e veprimtarisë dhe t'i kërkojnë atij leje për kërkesën e individit për të dhënë një kopje të të dhënave shëndetësore dhe personale të tij

51. Lidhur me të dhënat shëndetesore dhe personale që institucionet shëndetësore mbajnë, përveç në rastet kur një person i aftë ligjërisht para vdekjes ka dhënë një deklaratë me shkrim duke kërkuar zbulimin e të dhënave shëndetësore dhe personale, një vendim i tillë respektohet edhe pas vdekjes së tij, ndërsa në të gjitha rastet e tjera institucionet shëndetësore:

a) janë të detyruar të sigurojnë mbrojtje të të dhënave edhe pas vdekjes së individit të cilit i referohen

b) sigurojnë mbrojtje të të dhënave edhe pas vdekjes së individit të cilit i referohen me vendim të drejtorit të institucionit

c) nuk janë të detyruar të sigurojnë mbrojtje të të dhënave pas vdekjes së individit të cilit i referohen

d) sigurojnë mbrojtje të të dhënave edhe pas vdekjes së individit të cilit i referohen me vendim të doktorit

LIGJI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PACIENTËVE

52. Pacienti ka të drejtë të informohet për emrat, përgatitjen profesionale dhe specializimin e punonjësve shëndetësorë që i ofrojnë atij mbrojtje shëndetësore, përmes:

a) shfaqjës së detyrueshme të të gjitha formave të zhvillimit profesional të punonjësve shëndetësorë

b) shfaqjës së detyrueshme publike të licencës së punës të lëshuar nga Oda përkatëse, në vendin ku punon

c) shfaqjës publike të dëshmisë për provimin e dhënë profesional të punonjësit shëndetësor

d) shfaqjës publike të licencës së punës të lëshuar nga Oda përkatëse, në hyrje të institucionit

53. Lidhur me realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, institucioni shëndetësor:

a) nuk është i detyruar të ofroj këshilla ligjore dhe ndihmë juridike për pacientët

b) mund të ofroj këshilla ligjore dhe ndihmë juridike për pacientët vetëm nëse pacienti paguan për ato shërbime

c) është i detyruar të ofroj këshilla ligjore dhe ndihmë juridike për pacientët

d) është i detyruar të ofroj këshilla ligjore dhe ndihmë juridike për pacientët vetëm me miratimin e doktorit

54. Lidhur me realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, institucioni shëndetësor:

a) është i detyruar të informojë dhe trajnojë punëtorët shëndetësorë, bashkëpunëtorët shëndetësorë dhe punonjësit e tjerë në institucionin shëndetësor për realizimin e të drejtave të pacientëve në përputhje me ligjin

b) nuk është i detyruar të informojë dhe trajnojë punonjësit shëndetësorë, bashkëpunëtorët shëndetësorë dhe punonjësit e tjerë në institucionin shëndetësor për realizimin e të drejtave të pacientëve

c) mund të informojë dhe trajnojë punonjësit shëndetësorë, bashkëpunëtorët shëndetësorë dhe punonjësit e tjerë të institucionit shëndetësor për realizimin e të drejtave të pacientëve në përputhje me ligjin, por nuk ka detyrim për një gjë të tillë

d) informonë dhe trajnon punonjësit shëndetësorë, bashkëpunëtorët shëndetësorë dhe punonjësit e tjerë në institucionin shëndetësor për realizimin e të drejtave të pacientëve vetëm pas vlerësimit të drejtorit të institucionit

55. Lidhur me realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pacientëve në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Pacientëve, institucioni shëndetësor:

a) nuk është i detyruar të shfaqë tekstin e ligjit

b) është i detyruar të shfaqë tekstin e ligjit në një vend të dukshëm dhe lehtësisht të arritshëm vetëm nëse pacienti e kërkon atë

c) është i detyruar të shfaqë tekstin e ligjit në çfarëdo qoftë vendi në institucion, pavarësisht vlerësimit nëse është një vend i dukshëm dhe lehtësisht i arritshëm për pacientët

d) është i detyruar të shfaqë tekstin e ligjit në një vend të dukshëm dhe lehtësisht të arritshëm